



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 582/ Prot.  
3

Tiranë, më 10.03.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 32, datë 10.03.2025

**PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT DHE  
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË  
STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR  
VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78; Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, e ndryshuar; Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së nr.130, datë 13.12.2024 "Për miratimin e kuotave të pranimit, tarifave të konkurrimit dhe të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", i ndryshuar, si dhe bazuar në propozimet me shkresën nr. 5081/1 prot., datë 04.02.2025 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; shkresën nr. 1190/1 prot., datë 25.02.2025 të Ministrisë së Drejtësisë; shkresat nr. 1430/4 prot., datë 25.02.2025 dhe nr. 1430/5 prot., datë 04.03.2025 të Ministrisë së Brendshme; shkresën nr. 1215/1 prot., datë 25.02.2025 të Ministrisë së Mbrojtjes, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

**VENDOSI:**

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2024-2025, janë 316 (treqind e gjashtëmbëdhjetë) të ndara si më poshtë:
  - a) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 140;
  - b) Kuota pranimi nga Ministria e Drejtësisë 16;
  - c) Kuota pranimi nga Ministria e Brendshme 4;
  - d) Kuota pranimi nga Ministria e Mbrojtjes 3;
  - e) Kuota të lira (të pa mbuluara) 148;
  - f) Kuota për transferim të studimeve nga institucione jashtë vendit 5;
2. Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën l/a), b), c), d) dhe e) të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata në "Mjekësi Urgjence" dhe "Mjekësi Familje" fillimisht janë në dispozicion të kandidatëve të cilët i nënshtrohen

testimit të informatizuar dhe kualifikohen sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, dhe në kuotat e mbetura konkurrojnë kandidatët e tjerë që nuk i nënshtrohen testimit të informatizuar.

4. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (5 kuota) shpërndahen nga Rektori i UMT-së, bazuar në propozimin e dekanateve, sipas kërkesave të aplikantëve që vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë, jashtë vendit, në programe specializuese afatgjata të njëjta apo të të njëjtit profil. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
5. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (5 kuota) janë në mbështetje të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekët e specializuar. Studenti transferohet nga programe specializimi afatgjatë, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Kandidati që kërkon të transferohet sipas kësaj pike, duhet të marrë miratimin paraprak nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
6. Aplikojnë, për programe studimi specializuese afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, e ndryshuar.
7. Dokumentacioni i dorëzuar nga kandidati, i nënshtrohet konfirmimit të vërtetësisë me institucionet që e kanë lëshuar.
8. Pranimet e studentëve në programet specializuese afatgjata sipas kuotave të miratuara në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, e ndryshuar, të udhëzimit përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
9. Tarifa e aplikimit dhe konkurrimit në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifat e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
10. Studenti, i cilësuar përsëritës, në bazë të rregullores së UMT-së, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
11. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/b), c) dhe d) të këtij vendimi duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse. Studentët e shpallur fitues në kuotat sipas pikës 1/a), b), c) dhe d) të këtij vendimi lidhin kontratë me ministrinë përkatëse.

Modeli i kontratës dhe modalitet e lidhjes së saj, detyrimet, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre, është përgjegjësi e ministrive përkatëse, të cilat kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësive kryesore përkatëse të UMT-së, pa efekte buxhetore shtesë.
13. Vendimi nr. 21, datë 27.02.2025 i Senatit Akademik të UMT-së, shfuqizohet.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Ministrive përkatëse, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit tretë, në fushën e mjekësisë, ndryshuar.

**KRYETARI**  
**Prof. Dr. Xheladin DRAGNI**

The image shows a circular official stamp of the University of Medicine and Dentistry of Tirana (UMT). The text around the perimeter of the stamp reads "UNIVERSITETI I MJEKËSISË DENTARE" at the top and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp, there is a signature in black ink that appears to read "Xheladin Dragani". Above the stamp, the word "KRYETARI" is printed in bold capital letters. To the left of the stamp, the text "Prof. Dr. Xheladin DRAGNI" is printed in bold capital letters.

**TABELA NR. 1:** Shpërndarja e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, për vitin akademik 2024-2025

| Nr. | MJESIA KRYESORE | PROGRAMI I STUDIMIT                           | KUOTA TË MIRATUARA<br>PER V.A. 2024-2025 | KUOTA MINISTRIA E<br>SHËNDETËSISË DHE MS | KUOTA MINISTRIA<br>E BRENDSHME | KUOTA<br>MINISTRIA E<br>MBROJTJES | KUOTA<br>MINISTRIA E<br>DREJTËSISË | KUOTA TË LIRA PAS<br>PROPOZIMEVE TË<br>MINISTRIVE |
|-----|-----------------|-----------------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------------|--------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------------------|
| 1   | F. MJEKËSISË    | ALERGOLOGJI DHE IMUNOLOGJI KLINIKE            | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 2   | F. MJEKËSISË    | ANATOMI PATOLOGJIKE                           | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 3   | F. MJEKËSISË    | ANESTEZI-REANIMACION                          | 20                                       | 10                                       |                                |                                   |                                    | 10                                                |
| 4   | F. MJEKËSISË    | DIAGNOZË ME IMAZHE                            | 11                                       | 10                                       | 1                              |                                   |                                    | 0                                                 |
| 5   | F. MJEKËSISË    | DERMATOLOGJI DHE VENEROLOGJI                  | 5                                        |                                          |                                |                                   | 3                                  | 0                                                 |
| 6   | F. MJEKËSISË    | ENDOKRINOLOGJI                                | 5                                        | 5                                        |                                | 2                                 |                                    | 0                                                 |
| 7   | F. MJEKËSISË    | GASTROHEPATOLOGJI                             | 7                                        | 2                                        | 1                              |                                   |                                    | 0                                                 |
| 8   | F. MJEKËSISË    | HEMATOLOGJI                                   | 5                                        | 2                                        |                                |                                   |                                    | 4                                                 |
| 9   | F. MJEKËSISË    | KARDIOKIRURGJI                                | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 3                                                 |
| 10  | F. MJEKËSISË    | KARDIOLOGJI                                   | 8                                        | 7                                        | 1                              |                                   | 2                                  | 3                                                 |
| 11  | F. MJEKËSISË    | KIRURGJI E PËRGJITHSHE                        | 20                                       | 7                                        |                                |                                   |                                    | 0                                                 |
| 12  | F. MJEKËSISË    | KIRURGJI PLASTIKE, RIKOSTRUKTIVE DHE ESTETIKE | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 13                                                |
| 13  | F. MJEKËSISË    | LABORATOR KLINIK-BIOKIMIK                     | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 14  | F. MJEKËSISË    | MIKROBIOLOGJI                                 | 5                                        | 3                                        |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 15  | F. MJEKËSISË    | MJEKËSI FAMILJE                               | 30                                       | 17                                       |                                |                                   |                                    | 2                                                 |
| 16  | F. MJEKËSISË    | MJEKËSI INTERNE                               | 10                                       | 10                                       |                                |                                   |                                    | 13                                                |
| 17  | F. MJEKËSISË    | MJEKËSI LIGJORE                               | 5                                        |                                          |                                |                                   | 2                                  | 0                                                 |
| 18  | F. MJEKËSISË    | MJEKËSI URGJENCE                              | 15                                       | 15                                       |                                |                                   |                                    | 3                                                 |
| 19  | F. MJEKËSISË    | MJEKËSI TRANSFUZIVE                           | 5                                        | 2                                        |                                |                                   |                                    | 0                                                 |
| 20  | F. MJEKËSISË    | NEFROLOGJI                                    | 7                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 3                                                 |
| 21  | F. MJEKËSISË    | NEUROLOGJI                                    | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 7                                                 |
| 22  | F. MJEKËSISË    | NEUROKIRURGJI                                 | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 23  | F. MJEKËSISË    | OTORINOLARINGOLOGJI                           | 5                                        | 2                                        |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 24  | F. MJEKËSISË    | OBSTETRIKË-GJINEKOLOGJI                       | 10                                       | 5                                        |                                |                                   |                                    | 3                                                 |
| 25  | F. MJEKËSISË    | OKULISTIKË                                    | 5                                        |                                          | 1                              |                                   | 4                                  | 5                                                 |
| 26  | F. MJEKËSISË    | ONKOLOGJI                                     | 8                                        | 2                                        |                                |                                   |                                    | 0                                                 |
| 27  | F. MJEKËSISË    | ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJI                        | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 6                                                 |
| 28  | F. MJEKËSISË    | PEDIATRI                                      | 20                                       | 20                                       |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 29  | F. MJEKËSISË    | PNEUMOLOGJI                                   | 5                                        | 4                                        |                                |                                   |                                    | 0                                                 |
| 30  | F. MJEKËSISË    | PSIKIATRI                                     | 10                                       | 5                                        |                                |                                   | 1                                  | 1                                                 |
| 31  | F. MJEKËSISË    | PSIKIATRI E FEMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE        | 5                                        | 2                                        |                                |                                   |                                    | 4                                                 |
| 32  | F. MJEKËSISË    | REUMATOLOGJI                                  | 5                                        |                                          |                                | 1                                 |                                    | 3                                                 |
| 33  | F. MJEKËSISË    | SËMUNDJE INFECTIVE                            | 10                                       | 5                                        |                                |                                   |                                    | 4                                                 |
| 34  | F. MJEKËSISË    | SHËNDET PUBLIK                                | 10                                       |                                          |                                |                                   |                                    | 5                                                 |
| 35  | F. MJEKËSISË    | TOKSIKOLOGJI KLINIKE                          | 5                                        | 5                                        |                                |                                   |                                    | 10                                                |
| 36  | F. M. DENTARE   | KIRURGJI MAKSILO-FACIALE                      | 10                                       |                                          |                                |                                   | 4                                  | 0                                                 |
| 37  | F. M. DENTARE   | ORTODONCI                                     | 5                                        |                                          |                                |                                   |                                    | 6                                                 |
|     |                 |                                               |                                          |                                          |                                |                                   |                                    | 5                                                 |

\*5 kuota për transferim studimesh në Fakultetin e Mjekësisë, UMT, nga institucione jashtë shtetit.

5 kuota për transferim studimesh për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.